

NË EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit R. M. nga fsh. M., Komuna e Prizrenit, i akuzuar sipas propozim akuzës së PK ne Prizren PP.nr.4140/11 të dt.22.05.2012, për shkak të veprës penale ndotja, ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 276/1 te KPK të KPK-së, ne prezencën e te akuzuarit, perf. i te dëmtuarës, prokurorit te shtetit Besim Susuri, me dt.29.04.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. M., i lindur me *data e lindjes...* ne fsh.M. ku edhe jeton nga i ati R. dhe e ema Z., ka te kryer fakultetin ekonomik, drejtor i kompanis "R. H." i martuar babe i 4 fëmive, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

LIROHET NGA AKUZA

I.Se me dt.01.11.2010, ne kohe te pa përcaktuar ne fsh.R. Komuna e Prizrenit, në fushat e fshatit Q. (R.), Komuna e Prizrenit, i pandehuri në emër të firmës "R. H.", me makinerinë punuese si me eskavatorin e markës "Liebher-914" është hasur duke bërë shfrytëzimin ilegal të argjilës pa leje përkatëse, ashtu që degradon mjedisin dhe shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore duke shkaktuar rrezikë për mjedisin, kjo gjendje është konstatuar në vendin e ngjarjes nga Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale të Republikës së Kosovës.

-Këso dore do te kishte kryer veprën penale ndotja ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347par.1.te KPK-së.

II.Se me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin e I të kësaj propozim akuze shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve dhe pasurinë e një rëndësie thelbësore me anë të forcës mekanike, në atë mënyrë që i pandehuri me anë të makinerisë bën gërmimin e tokës në afërsi të objekteve të banimit me ç'rast krijon gropa të mëdha dhe bën të pasigurte jetën e njerëzve si dhe mundësisë së çarjes së objekteve të banimit që gjenden shumë afër vend shfrytëzimit.

-Këso dore do të kishte kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi 1 të KPK-së.

- nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale .

E dëmtuara Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale ne Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijne ne ngarkesë te mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

PK-ja në Prizren, ka paraqitur propozim akuzën PP.nr.4138/2011 të dt.13.09.2012 kundër të akuzuarit R. M. nga fsh. M., për shkak të veprës penale ndotja, ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 276/1 të KPK-së dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi 1 të KPK-së.

Ne shqyrtimin gjyqësor të datës 29.04.2016, gjykata procedoi këtë çështje penale në rigjykim sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit PA1.nr. 1401/15 të datës 12.01.2016.

Gjyqtari gjykues duke iu përmbajtur udhëzimeve sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të cekur më lartë procedojë këtë çështje penale sipas propozim akuzës PP.nr.4140/11 të datës 22.05.2012, kur të kihet parasysh fakti se me këtë propozim akuzë janë të përfshira dy dispozitave sipas kësaj çështje penale.

Prokurori i shtetit, në fjalën hyrëse si dhe në fjalën përfundimtare deklaroj se, qëndron në tërësi pranë të thënave si në propozim akuzë të kësaj Prokurorie ku me provat e propozuara do të vërtetohet fajësia e të pandehurit R. M., për kryerjen e veprave penale ndotja ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 276 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së dhe të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi 1 të KPK-së, kryerja e të cilave i vihet në barrë dhe se i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Kurse në fjalën përfundimtare potencon, se mbetem në tërësi pranë të thënave si në propozim akuzë ngase nga provat e administruara gjer më tani me pamëdyshje vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprave penale ndotja ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 276 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së dhe veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi 1 të KPK-së. Ndërkaq deklaratave të pandehurit të dhënë në shqyrtimin e sotëm të cilat për mua kanë qenë herë herë kundërthënëse në mes vete të paargumentuara dhe jo bindëse nuk mund t'i kushtohet besimi i plotë. Andaj kërkoj që i njëjti të shpallet përgjegjës për veprat penale të përmendura dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës, mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, duke theksuar atë se duke u bazuar në provat e administruara në këtë shqyrtim konsiderojë me bindje të plotë se është argumentuar fakti se ndërmarrja R. H. me pronarë R. M., ka operuar në mënyrë ilegale pa poseduar licencë nga KPMM.

I akuzuari R. M. në mbrojtjen e tij në shqyrtimin kryesor si dhe në fjalën përfundimtare nuk ka pranuar kryerjen e veprës penale duke deklaruar se me asnjë prove nuk mund të vërtetohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Për paraqitjen e provave në këtë çështje penale gjyqtari gjykues miratoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit i cili kërkoi që meqenëse janë dëgjuar dëshmitarët në këtë çështje penale dhe se deklaratat e tyre gjenden në shkresat e lëndës e kur të kihet parasysh fakti se veprimet për veprën penale për të cilën ngarkohet i akuzuari sipas pikës I të aktakuzës janë të ndërlidhura thelbësisht edhe me pikën II të aktakuzës atëherë është e panevojshme dëgjimi i dëshmitarëve, andaj me qëllim të efikasitetit të kësaj procedure bëhet vetëm leximi i deklaratave të tyre nga shqyrtimet gjyqësore.

Duke vlerësuar provat e administruara ne procedure gjykata ka vërtetuar kete gjendje faktike:

Nuk është kontestuese se kompania R. H. sh.p.k.operon ne komunën e Prizrenit,ne f. R. –M.,te njëjtën e përfaqëson drejtori ekzekutiv R. M., kurse veprimtari kryesore e kompanisë është prodhimi i bllokave te argjilës.

Me datën 01.11.2010.inspektoret e komisionit te pavarur per miniera dhe minerale i kane lëshuar urdherese kompanisë R. H. qe menjëherë te ndërpres operimin ilegal te shfrytëzimit te argjilës meqenëse e njëjta nuk dispononte me licence perkatese.

Me datën 08.11.2010.inspektoret e te dëmtuarës kane paraqitur raport te inspektimit ilegal, me konstatim se kompania zhvillon aktivitet ilegal, dhe ne momentin e inspektimit kompania nuk ka qene duke punuar, kurse ne vend shfrytëzim nuk ka patur pajisje . Urdhëresa per ndërprerje te aktivitetit nuk iu është dorëzuar dikujt ne vendin e ngjarjes me qenese askush nuk ka qene ne vend per ta pranuar. Ne lokacionin sipas koordinatave te përshkruara ne raport kompania është hasur per here te pare, kurse si rezultat i nje shfrytëzimi te tillë eshte krijuar teren i rrezikshëm per rrethin.

Nga deponimet e dëshmitarit M. B. vërtetohet se i njëjti ne cilësinë e zyrtarit regjional per resurse dhe miniera dhe minerale se bashku me inspektorin e minierave ditën kritike me 01.11.2010, kanë dalë ne teren dhe kane konstatuar se ne vendin afër kompanisë “R. H.” është duke u shfrytëzuar materiali mineral – argjila pa licence. Përkundër përpjekjeve dhe kërkesave qe i pandehuri ka bere per te siguruar lejet përkatëse , procedurat kane qene te tilla te cilat zgjasin për dy vite andaj i njëjti nuk ka arritur qe te licencohet. Ditën e inspektimit nuk e kishin hasur ne vendin e ngjarjes ndonjë punëtor apo person tjetër ne vendin ku merrej materiali mineral – argjila perveq nje eskavatori. Nuk e kishin njoftua policinë lidhur me rastin edhe pse ishin ne dijeni se kishin obligim ligjore ta bënin kete.

Nga deponimet e dëshmitarit H. M. vërtetohet: me datën 01.11.10 dëshmitari me koleget e tjerë inspektor, kishin inspektua tri lokacione ku operonte kompania “R. H.”. Kishin kryer punët e tyre zyrtare duke përpiluar raportin lidhur me operimet ilegale qe kishin ndodhur ne ato lokacione, incizimin e terrenit me koordinata. Konstatimin se përpunimin e lendes minerale e bënte kompania “R. H.” . ne njërën prej atyre zonave kompania ne fjalë kishte paraqitur kërkesë per hulumtim por e njëjta nuk ishte e pajisur me licencë. Nuk kishin hasur ndonjë punëtor ne vendin ku konsumohej argjila, është hasur vetëm një ekskavator i cili nuk ka patur ndonjë mbishkrim. Ne konkludimin se, kompania “R. H.” ishte ajo qe konsumonte argjilën kishin ardhur ne konstatim bazuar ne kërkesën qe pikërisht kjo kompani kishte paraqitur kërkesën qe te licencohet per hulumtim duke shtuar edhe mundësinë qe aktiviteti i shfrytëzimit ka mundur qe te behej edhe nga ndonjë kompani tjetër per nevojat e kompanisë “R. H.” .

Gjykata ne mënyrë te veçantë vlerëson saktësinë e provave, arsyet ne te cilat eshte bazuar me rastin e zgjidhjes se kësaj çeshtje penale juridike, veqanerisht me rastin per vërtetimin e ekzistimit te veprës penale dhe përgjegjësisë penale te te akuzuarit.

Mbrojtjen e te akuzuarit gjykata e ka aprovuar ne tërësi. Duke patur per baze provat e administruara me larte e ne veqanti deponimet e dëshmitarëve M. B. dhe H. M. te cilët ne raportet e tyre te inspektimit kishin konstatuar faktin se këtu i akuzuari kishte operuar ilegalisht

ne shfrytëzimin-përpunimin e lendes minerale – argjilës por nuk kishte konstatim të ken hasur ndonjë punëtor nga ana e kompanisë “R. H.”. Kishin hasur në vendin e ngjarjes vetëm një ekskavator për të cilin nuk kishte asnjë mbishkrim se kujt i njëjti i takonte.

Inspektoret e Komisionit të pa varur për Miniera dhe Minerale, me rastin e inspektimit sipas detyrave të tyre zyrtare, ditën kur kanë qene në vendin e ngjarjes dhe kanë përpiluar urdhëresën dhe raportet, nëse do të kishin besuar se ndonjë person është duke ushtruar aktivitete të jashtëligjshme atëherë bazuar në nenin 70 të Ligjit për Miniera dhe Minerale (ligji nr.03/L-163), do të duhej që menjëherë ta informonin policinë e Kosovës. Pas procedimit të qeshtjes do të duhej që të verifikoheshin identiteti i personave në ato aktivitete dhe rrjedhimisht do të rezultonte edhe identifikimi i kryesit të veprës penale.

Në rastin konkret nuk është vërtetuar me prova bindëse identiteti subjektiv i kryesit të veprës penale.

Prova bindëse për vërtetimin e fakteve që do të bazonin ekzistimin e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri nuk ka. Provat janë të drejtuara drejt vërtetimit të fakteve se i pandehuri nuk posedon me licencë përkatëse për shfrytëzimin të argjilës. Me asnjë provë bindëse nuk u demonstrua në shqyrtimet gjyqësore se i pandehuri me veprimet e tij personale ose dikush nga subjektet e kompanisë të cilën e udhëheqë i pandehuri janë hasur në kryerjen e veprës penale.

Bazuar në nenin 3 par.2 të KP lidhur me zbatimin e ligjit me të favorshëm ndaj të pandehurit është aplikuar neni 347 i KP-së.

Nga ajo që u tha më lartë kjo gjykatë e liroi nga akuza të akuzuarin konformë dispozitës e nenit 364 1-1.3 të KP-së.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest civil u mur në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mur në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP.

**GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN,
P.nr.368/16 të dt.29.04.2016**

**Procesmbjatesi.
Teuta Spahiu**

**Gjyqtari:
Refki Piraj**

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykatë.